



KESHILLI I BASHKISE KORÇE

VENDIM

Nr. 74 Al Y.P.

Për akordimin e fondit prej 500 000 lekë, për realizimin e Spektaklit “Maratona e Kenges Popullore” ne qytetin e Korces.

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korcës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit për akordimin e fondit prej 500 000 lekë, i cili përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980	05	art	609 0000 – 500 000 leke
Shtohet	00	08250	05	art	602 0000 + 500 000 leke

Mbështetur në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 9936 dt.26.06.2008"Per menaxhimin e Sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise", ne Ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2009", Udhëzimit nr 2 dt. 12.01.2009 te M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2009", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 13.02.2009 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009", si dhe mbas diskutimeve te keshilltareve:

VENDOSI:

1. Të miratojë akordimin e fondit prej 500 000 lekë, i cili përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të bashkisë me këtë strukturë buxhetore dhe që do të shpenzohet sipas detajimit bashkëngjitur.

Pakësohet	00	04980	05	art	609 0000 – 500 000 leke
Shtohet	00	08250	05	art	602 0000 + 500 000 leke

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Drejtoria Juridike dhe Qendra Kulturore "Vangjush Mio"

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI